

Luljeta BOZO



Datëlindja: 2.10.1942

Vendlindja: Tiranë

E-mail: Luljeta.Bozo@parlament.al

Jetëshkrimi

Ka lindur në Tiranë më 2 tetor 1942. Ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën inxhinieri ndërtimi në vitin 1965, ku ka përfunduar edhe doktoraturën në vitin 1989 dhe prej vitit 1994 mban titullin “profesore”. Është kryetare e Shoqatës së Gjeoteknikëve të Shqipërisë dhe anëtare e Shoqatës Botërore të Mekanikës së Dherave dhe Gjeoteknikës Inxhinierike. Që prej vitit 2011 është anëtare e Shoqatës Amerikane për Përparimin e Shkencës (AAAS) dhe anëtare e Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave. Në vitin 2002 u përfshi nga *International Biographical Centre në Cambridgeshire* në botimin e tretë (*The International Who's Who of Women 2002*), si një nga gratë shkencëtare më të mira të vitit.

Është një nga emrat më të vlerësuar akademike në Shqipëri, me 52 vjet aktivitet pedagogjik në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politenik të Tiranës, në Universitetin “Epok” dhe Universitetin “Polis”.

Është autore e 33 librave në fushën e inxhinierisë, shkencës dhe gjeoteknikës, 4 dispencave për nivelin master dhe bachelor, 3 monografive, 63 punimeve në simpoziume, konferenca ndërkombëtare në gjithë botën, bashkautore në tema shkencore me rëndësi kombëtare, me dhjetëra studime e projektme në fushën e gjeoteknikës, udhëheqëse e dhjetëra diplomave, mikrotezave për master shkencor dhe doktoraturave, anëtare e shumë forumeve dhe komiteteve shkencore në konferenca ndërkombëtare gjatë gjithë aktivitetit të saj si anëtare e Senatit të Universitetit, zëvendësdekane, përgjegjëse departamenti etj.

U zgjodh deputete e Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021 dhe është anëtare e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

